

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Lidhja / *el-ittisaal* / الإِتِّصَالُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"ثُمَّ دَنَا فَتَدَلَّى * فَكَانَ قَابَ قَوْسَيْنِ أَوْ أَدْنَىٰ"

أَيَسَّ الْعُقُولَ بِقَوْلِهِ: "أَوْ أَدْنَىٰ."

"Pastaj u afrua dhe zbriti, dhe qëndroi në një distancë prej dy harqesh a më afër."¹ (en-Nexhm, 8-9)

Ai bëri që mendja të humbë shpresën duke thënë: "... a më afër"²

Lidhja (i'ttisaal) ka tri nivele: e para është lidhja e kërkimit të shpëtimit (*i'tisaam*), pastaj lidhja e të parit (*shuhuud*), pastaj lidhja e realitetit (*wuxhuud*).

Lidhja e kërkimit të shpëtimit ka të bëjë me:

- Ndrejjen e nijetit
- Dëllirjen e vullnetit
- Realizimin e gjendjes së brendshme (*haal*)³

¹ Shejhu (el-Harawi) e kuptoi këtë ajet të flasë për Zotin, siç u kuptua edhe nga disa komentues të tjerë, por pozicioni më i fortë është se ky ajet flet për Xhibrilin. Megjithatë, synimi këtu është më se i qartë: kur ti i afrosh Zotit, Ai të afrohet ty, siç është provuar në Sunet.

² Bazuar në interpretimin e shejhut, ai mendon se përmendja e Tij e "a më afër" synon ta bëjë mendjen të humbë shpresat se do ta njohë realitetin e atij takimi.

³ Kur dija çon në veprimin devocional dhe kjo më pas çon në gjendjen e vëmendjes së plotë të brendshme, të kujdesit, të merakut, të mirëbesimit, dhe të dashurisë.

Niveli i dytë është lidhja e të parit, gjë që ka të bëjë me:

- Heqjen e të metave⁴
- Mospasjen e nevojës për prova⁵
- Eliminimin e shkapërderdhjes së mendimeve⁶

Niveli i tretë është lidhja e realitetit (*wuxhuud*)⁷. Kjo lidhje s'mund të kuptohet me anë të përshkrimeve ose përkufizimeve, po vetëm të tregohet me anë të emrave⁸ të huazuar dhe me gjesteve.

⁴ Të metat e veprimeve dhe të gjendjeve janë të shumta, por më seriozja është ndjenja e meritës (D.m.th. ndjenja se ti meriton diçka).

⁵ Shenjat treguese nuk janë të nevojshme, kur të arrish në vendmbërritje. Dija për Zotin është e papërmbajtshme (*daruri*), por janë mjegulla e gjynahut, animi, pasimi i verbër dhe motivet e ulëta ato që pengojnë personin ta shohë të vërtetën.

⁶ Bashkimi tash është edhe i jashtëm, edhe i brendshëm; madje edhe mendimet janë të mbledhura dhe të bashkuara.

⁷ Realiteti (*wuxhuud*) mund të jetë një emër, domethënë një "ekzistencë" a një emër foljor, pra një "gjetje". Kjo nënkupton të dytën nëpërmjet aluzionit nga e para. Kjo nënkupton gjetjen e Zotit, që është ekzistenca e vërtetë, e domosdoshme, si dhe bërësi e mbajtësi i tërë ekzistencës. Ky është niveli që shejhu i kushton *fanaa-s* (vetasgjësimit) ose humbjes së vetvetes për të gjetur atë, humbjes së *nefsit* tënd për të gjetur shpirtin tënd, qëndrimin vetëm me Të, për Të, pranë Tij. Shih shkallën (stacionin) 96 të Njëmendësisë.

⁸ Këta emra, që huazohen nga gjuha jonë njerëzore, e cila është e kufizuar nga përvojat tona njerëzore, thjesht vetëm na tregojnë për koncepte, realiteti ontologjik (botëkuptimor) i të cilëve është krejtësisht jashtë të kuptuarit tonë.